



Republika e Kosovës/ Republika Kosovo/ Republic of  
Kosovo  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački savet Kosova/  
Kosovo Prosecutorial Council



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of  
Kosovo  
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

# Strategjia për Komunikim e Sistemit Prokurorial

2018-2020

## Përmbajtja

HYRJE .....	3
MISIONI .....	4
VIZIONI .....	4
GJENDJA AKTUALE .....	4
METODOLOGJIA .....	5
KORNIZA LIGJORE .....	6
KUFIZIMET LIGJORE .....	8
LISTA E SHKURTESAVE .....	8
OBJEKTIVAT .....	9
OBJEKTIVA I - NGRITJA E BESUESHMËRISË NË SISTEMIN PROKURORIAL TË KOSOVËS .....	9
a) Rritja e komunikimit me publikun, synohet të arrihet përmes aktiviteteve si:.....	9
b) Përmirësimi i komunikimit të brendshëm, që synohet të arrihet përmes aktiviteteve si: 10	
c) Ngritja e koordinimit ndërinstitucional në fushën e komunikimit, përmes aktiviteteve si: 10	
OBJEKTIVA II - NGRITJA E BASHKËPUNIMIT ME MEDIA .....	11
a) Ngritja e resurseve adekuate njerëzore për komunikim me media, që synohet të arrihet përmes aktiviteteve si: .....	11
b) Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve për media dhe prokurorëve, që synohet të arrihet përmes aktiviteteve si: .....	11
c) Ngritja e kapaciteteve të gazetarëve të sektorit të drejtësisë në bashkëpunim me AGK- në, që synohet të arrihet përmes aktiviteteve si:.....	11
OBJEKTIVA III - NGRITJA E BASHKËPUNIMIT ME SHOQËRINË CIVILE .....	12
OBJEKTIVA IV - KOMUNIKIM EFIKAS DHE EFEKTIV PËR RASTET SPECIFIKE DHE URGJENTE.....	12
PLANI I VEPRIMIT .....	14

## HYRJE

Strategjia për komunikim publik është një nismë e re dhe përpjekje për të përmirësuar cilësinë e komunikimit të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, duke inkurajuar pjesëmarrjen dhe informimin e qytetarëve, dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës për opinionin e gjerë publik. Njëkohësisht duke ngritur përmes aktiviteteve konkrete besueshmërinë në sistemin prokurorial të Kosovës, si dhe ngritjen e bashkëpunimit me mediat për hir të informimit të shpejtë dhe të saktë të opinionit lidhur me punën e prokurorive.

Komunikimi i sistemit prokurorial tashmë ka ndryshuar formë kur kemi të bëjmë me komunikimin e jashtëm. Për transparencë dhe efikasitet më të madh, sistemi prokurorial duhet të jetë interaktiv në komunikim me mediat dhe publikun e gjerë. Ky komunikim përveç informimit të vazhdueshëm për rastet e ndryshme, apo dhënien e përgjigjeve në pyetjet e gazetarëve, përfshinë edhe ngritjen e vetëdijesimit për punën e sistemit prokurorial. Është po ashtu me rëndësi që me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të komunikimit me opinionin publik, sistemi prokurorial në vazhdimësi të vlerësojë opinionin e akterëve të ndryshëm.

Objektiv është përmirësimi i perceptimit publik për sistemin prokurorial, si dhe rritja e nivelit të besueshmërisë së qytetarëve në punën e këtij sistemi.

Kjo strategji e komunikimit duhet të reflektojë planet e përgjithshme të sistemit prokurorial të vendit tonë për tre vite (2018-2020).

## MISIONI

Strategjia përmes objektivave dhe aktiviteteve synon që të ngrit nivelin e besueshmërisë ndaj punës së sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, dhe njëherësh të ngrit bashkëpunimin më efektiv dhe më efikas me mediat dhe shoqërinë civile me qëllim të informimit të drejtë dhe të saktë të opinionit lidhur me punën e prokurorive, si dhe avancimit të punës së zyrtarëve të tyre.

## VIZIONI

Sistemi prokurorial i Kosovës të ndërtojë mekanizma të qëndrueshëm të komunikimit më efikas dhe më efektiv me publikun për hir të informimit të drejtë dhe të saktë lidhur me punën e prokurorive dhe rasteve me interes publik.

## GJENDJA AKTUALE

Sistemi prokurorial përballet me një numër sfidash të natyrave të ndryshme, të cilat në mënyrë direkte ose indirekte ndikojnë në marrëdhënien e saj me publikun. Fillimisht, ky sistem duhet ta kuptojë rëndësinë që ka fusha e marrëdhënieve me publikun, duke përfshirë komunikimin e sistemit me akter të jashtëm në përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të punës së vet sistemit prokurorial.

Sfidë e vazhdueshme në realizmin e këtyre objektivave konsiderohen zhvillimet socio-ekonomike në vend, rritja e numrit të medimeve dhe gazetarëve në përgjithësi dhe hapësira e veprimit, në varësi të këtyre zhvillimeve.

Ana financiare mbetet rrezik, pasi që si pasojë mund të ketë mungesë të stafit të mjaftueshëm dhe kjo mund të sjell vështirësi në realizimin e synimeve dhe objektivave.

Ndërtimi i një kulture të brendshme komunikimi i të punuarit brenda sistemit për realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Gatishmëria për bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve të prokurorëve dhe stafit mbështetës me zyrat për komunikim publik mbetet sfidë e realizimit të objektivave.

Si sfidë tjetër mbetet kompletimi me staf të mjaftueshëm të zyrës për përkthim, me qëllim të përkthimit në kohë të të gjitha materialeve duke u bazuar në Ligjin për përdorimin e gjuhëve në Kosovë.

Anën tjetër, Prokuroria e Apelit si dhe shtatë (7) prokuroritë Themelore në Kosovë nuk kanë të caktuar zyrtar adekuat që merren me çështje të komunikimit, duke bartur kështu tërë përgjegjësinë e komunikimit me publikun tek Zyra për Komunikim Publik e Prokurorit të Shtetit, e cila përballlet me ngarkesë të kërkesave nga ana e mediave dhe mungesë të kapaciteteve për të adresuar të gjitha informatat me interes për publikun në mënyrë të trajtuar.

Ekziston akoma nevoja e hartimit dhe rishikimit të dokumenteve dhe rregulloreve strategjike që e rregullojnë çështjen e komunikimit të brendshëm të zyrtarëve për komunikim dhe prokurorëve, si dhe komunikimit me jashtë, që do të përfshinte komunikimin me media, si transmetuese tek opinioni i gjerë, si dhe komunikimi me shoqërinë civile e cila ka rol jetik në vetëdijesimin e shoqërisë për rëndësinë e një sistemi të pavarur, të paanshëm, profesional dhe me integritet prokurorial.

Për pasojë është nisur edhe hartimi i Strategjisë së parë të komunikimit të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, për tre vitet e ardhshme (2017-2020), e që ka 4 objektiva dhe 19 nënobjektiva të cilat kjo strategji synon përmes aktiviteteve konkrete të i arrijë, me qëllimin kryesor të ngritjes së besueshmërisë së qytetarëve në sistemin prokurorial të Kosovës përmes komunikimit, si dhe rregullimin e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.

## **METODOLOGJIA**

Hartimi i kësaj strategjie është bërë përmes një procesi gjithëpërfshirës, me pjesëmarrjen e të gjithë akterëve kyç në zbatimin e kësaj strategjie, si përfaqësues të sistemit prokurorial, Zyrës së Koordinatorit për gazetarë në Prokurorin e Shtetit, përfaqësues të gazetarëve (Asociaicioni i Gazetarëve të Kosovës), përfaqësues të mediave dhe të shoqërisë civile.

Gjatë hartimit të kësaj strategjie janë shqyrtuar në mënyrë të detajuar të gjitha raportet vlerësuese dhe dokumente tjera lidhur me zbatimin e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm të sistemit prokurorial, përfshirë këtu rregulloren e brendshme të komuniimit si dhe ligjet tjera në fuqi në Kosovë.

## KORNIZA LIGJORE

Strategjia në përmbajtjen e saj është brenda kornizës ligjore dhe nënligjore që rregullon funksionimin e sistemit prokurorial në Kosovë, sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës në përgjithësi, të drejtën e opinionit për të u informuar dhe liritë, të drejtat dhe privatësinë e të gjitha palëve në procedurat penale.

Përveç kornizës ligjore që do të paraqitet më poshtë, kjo strategji ka marrë parasysh dhe do të respektojë të gjitha konventat ndërkombëtare të cilat në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mos respektimi i tyre automatikisht shkakton pasoja juridike.

Korniza ligjore në të cilën është mbështetur kjo strategji është:

- KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
- KODI I PROCEDURES PENALE I KOSOVËS NR. 04/L-123
- KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS NR. 04/L-082
- KODI I DREJTËSISË PËR TË MITUR NR. 03/L-193
- LIGJI NR. 03/L-224 - PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS
- LIGJI NR. 03/L-225 - PËR PROKURORIN E SHTETIT
- LIGJI NR. 03/L-052 - PËR PROKURORINË SPECIALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
- LIGJI NR. 05/L-035 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-224 PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS
- LIGJI NR. 05/L-034 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.03/L-225 PËR PROKURORIN E SHTETIT
- LIGJI NR. 04/L-043 PËR MBROJTJEN E INFORMATORËVE
- LIGJI NR. 04/L-015 PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE
- LIGJI NR. 03/L-057 PËR NDËRMJETËSIM
- LIGJI NR. 04/L-050 PËR DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E PASURISË TË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK DHE DEKLARIMIN, PREJARDHJEN DHE KONTROLLIN E DHURATAVE PËR TË GJITHË PERSONAT ZYRTARË

- LIGJI NR. 04/L-051 PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK
- LIGJI NR. 04/L-31 PËR BASHKËPUNIM JURIDIK NDËRKOMBËTAR NË ÇËSHTJET PENALE
- RREGULLORE NR.04/2017 - PËR KLASIFIKIMIN E INFORMACIONEVE TË SISTEMIT PROKURORIAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
- RREGULLORE NR.06.2016 - PËR KOMUNIKIM PUBLIK
- RREGULLORE NR. 05.2016 - PËR NJËSINË NDËRLIDHËSE PËR PËRGJIME
- RREGULLORE NR.04.2016 - PËR BASHKËPUNIM INSTITUCIONAL
- RREGULLORE NR.11.2015-PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORIT TË SHTETIT
- RREGULLORE NR.10.2015-PËR ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS
- RREGULLORE NR.03/2017 - PER KOMISIONIN PER ADMINISTRIMIN E PROKURORIVE
- KODI I ETIKËS DHE SJELLJES PROFESIONALE PËR PROKURORË
- KODI I ETIKËS DHE SJELLJES PROFESIONALE PËR ANETARËT E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVË
- KODI I ETIKËS PROFESIONALE PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS

## KUFIZIMET LIGJORE

Kjo Strategji dhe aktivitetet e saj do t'i nënshtrohen kufizime ligjore, në raste të kërkesave të informatave, të cilat janë të mbrojtura me ligje dhe akte nënligjore, në raste të informatave të cilat mund të dëmtojnë hetimet dhe shkelin të drejtat dhe liritë e njeriut, informatave të cilat kufizohen me ligj dhe që shkaktojnë pasoja juridike për publikuesin e atyre informatave, si dhe në çdo rast duhet të mbrohet e drejta e gazetarëve për të përdorur dhe për t'i mbrojtur burimet anonime të informacionit, me përjashtim të atyre rasteve kur ligjet e parashohin ndryshe.

Opinionit ka të drejtë të informohen në kohën e duhur për zhvillimet në hetimet konkrete dhe rastet penale. Me rastin e informimit të opinionit, gjithmonë do t'i jepet përparësi rasteve me interes të publikut, por pa dëmtuar interesin e hetimeve dhe të drejtat e palëve në procedurë penale.

Gjatë informimit të publikut do të gjendet ekuilibri i duhur në mes të transparencës në njërën anë dhe interesit të publikut dhe një procedure penale të drejtë duke e përfshirë edhe privatësinë e palëve në procedurë në anën tjetër. Do të respektohet pozita dhe aktet juridike të sistemit prokurorial, atij gjyqësor, privatësia e palëve në procedurë siç janë: i dyshuari, viktimat, të afërmet e tyre, dëshmitarët dhe interesi i publikut.

Përveç kësaj do të merret në konsideratë ekuilibri në mes të transparencës dhe interesit të hetimit. Me këtë rast do të bëhet hapja e informatave aty kur është e mundur dhe do të mbahen informatat aty kur është e nevojshme, gjithmonë duke respektuar interesin e publikut, interesin e hetimeve dhe të drejtat e palëve në procedurë penale.

## LISTA E SHKURTESAVE

KPK.....	Këshilli Prokurorial i Kosovës
PSH.....	Prokurori i Shtetit
MASHT.....	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MPB.....	Ministria e Punëve të Brendshme
AGK.....	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës



## OBJEKTIVAT

Në kuadër të kësaj strategjie janë paraparë 4 objektiva dhe 19 nënobjektiva të cilat synohen të arrihen përmes aktiviteteve konkrete të parapara sipas planit të veprimit dhe afateve kohore. Zbatimi i aktiviteteve në praktikë do të varet krejtësisht nga kostoja financiare dhe mbulimi buxhetor i tyre.

### OBJEKTIVA I - NGRITJA E BESUESHMËRISË NË SISTEMIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

Kjo objektivë ka për qëllim që përmes komunikimit me opinionin publik, si mjet, të ngritë nivelin e besueshmërisë së qytetarëve në sistemin prokurorial të Kosovës dhe njëherësh përmes ngritjes së besueshmërisë të ngrit edhe nivelin e bashkëpunimit me qytetarët për raste të ndryshme kriminale, me qëllim të trajtimit sa më efikas të tyre dhe vënies së drejtësisë.

Kjo objektivë ka tri nënobjektiva që synohet të përmbushen përmes aktiviteteve konkrete të parapara në Planin e Veprimit të kësaj strategjia (Shih Planin e Veprimit të bashkëlidhur në dokument), si ne vijim;

#### a) Rritja e komunikimit me publikun, synohet të arrihet përmes aktiviteteve si:

- Publikimi i buletinit të sistemit prokurorial;
- Realizimi i fushatave vetëdiesuese (mbajtja e ligjëratave nëpër institucionet edukative arsimore, realizimi i spoteve televizive, broshurave dhe materiale tjera informuese);
- Organizimi i konferencave të rregullta;
- Organizimi i takimeve të rregullta me qytetarë;
- Përmirësimi i funksionimit të faqes zyrtare;
- Njoftimi i publikut lidhur me rastet e paraqitura nga qytetarët dhe nga mediat, si dhe rastet e iniciuara sipas detyrës zyrtare.

**b) Përmirësimi i komunikimit të brendshëm, që synohet të arrihet përmes aktiviteteve si:**

- Organizimit të takimeve mujore apo sipas nevojës të prokurorëve dhe zyrtarëve për komunikim;
- Informimit të përditësuar i kryeprokurorëve për rastet e ndjeshme për publikun, nga prokurori i rastit;
- Informimit të përditësuar i zyrtarëve për komunikim publik për rastet e ndjeshme për publikun, nga prokurori i rastit

**c) Ngritja e koordinimit ndërinstitucional në fushën e komunikimit, përmes aktiviteteve si:**

- Mbajtja e takimeve të rregullta dhe sipas nevojës polici, prokurori, gjykatë dhe institucioneve tjera;
- Krijimi i ekipit të përbashkët për komunikim ndërinstitucional (të sigurisë dhe drejtësisë);
- Lidhja e memorandumeve të bashkëpunimit në mes institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në fushën e komunikimit me publikun;
- Mbajtja e konferencave të përbashkëta në mes të policisë dhe prokurorisë dhe sipas nevojës edhe me institucionet tjera zbatuese të ligjit;
- Organizimi i trajnimeve të përbashkëta me institucione zbatuese të ligjit për çështjet e komunikimit.

## OBJEKTIVA II - NGRITJA E BASHKËPUNIMIT ME MEDIA

Kjo objektivë e ka për qëllim që të ngrit nivelin e komunikimit me mediat, si transmetues kryesor të informatave tek opinioni publik dhe akterë kyç në informimin e drejtë dhe të saktë të opinionit lidhur me punën e sistemit prokurorial.

Kjo objektivë ka katër nënobjektivat si në vijim:

**a) Ngritja e resusreve adekuate njerëzore për komunikim me media, që synohet të arrihet përmes aktiviteteve si:**

- Caktimi i prokurorëve përgjegjës për komunikim, në të gjitha prokuroritë;
- Caktimi i prokurorit koordinator përgjegjës për komunikim;
- Caktimi i zyrtarëve përgjegjës për komunikim, në të gjitha prokuroritë dhe KPK-në.

**b) Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve për media dhe prokurorëve, që synohet të arrihet përmes aktiviteteve si:**

- Krijimi i kushteve teknike për realizimin e detyrave të punës të zyrave për komunikim;
- Trajnimi i zyrtarëve dhe prokurorëve për komunikim me publikun.

**c) Ngritja e kapaciteteve të gazetarëve të sektorit të drejtësisë në bashkëpunim me AGK-në, që synohet të arrihet përmes aktiviteteve si:**

- Unifikimi i praktikave për qasje në dokumente publike;
- Organizimi i trajnimeve të përbashkëta me gazetarë;
- Krijimi i një grupi jo formal të zyrtarëve për komunikim, prokurorëve dhe gazetarëve të drejtësisë në bashkëpunim me AGK-në;
- Mbajtja e takimeve të Kryeprokurorit të Shtetit (dy herë në vit) me kryeredaktorët/redaktorët të mediave në bashkëpunim me AGK-në.

## **OBJEKTIVA III - NGRITJA E BASHKËPUNIMIT ME SHOQËRINË CIVILE**

Kjo objektivë ka rol jetik sidomos në ngritjen e vetëdijes qytetare për rolin e një sistemi të paanshëm, profesion dhe me integritet prokurorial. Roli i shoqërisë civile, si transmetues por edhe duke pasur parasysh ekspertizën profesionale që mund të ofrohet në ngritjen e kapaciteteve të sistemit prokurorial është krucial në drejtim të zbatimit të kësaj strategjie. Andaj kjo objektivë nuk ka nënobjektiva por ka katër aktivitete kryesore që parashihen të realizohen me qëllim të arritjes së kësaj objektive, e ato janë:

- Organizimi i hulumtimeve të përbashkëta, lidhur me zhvillimin e kriminalitetit dhe çështje të tjera me rëndësi;
- Organizimi i takimeve të përbashkëta për çështjet që i përkasin sistemit prokurorial;
- Organizimi i trajnimeve të përbashkëta, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve,
- Lidhja e memorandumeve të bashkëpunimit.

## **OBJEKTIVA IV - KOMUNIKIM EFIKAS DHE EFEKTIV PËR RASTET SPECIFIKE DHE URGJENTE**

Kjo objektivë ka për qëllim kryesor që të garantojë një komunikim më efektiv të brendshëm, pra brenda për brenda sistemit prokurorial por edhe një komunikim më efektiv ndërinstitutional, me institucione tjera të drejtësisë dhe ato të zbatimit të ligjit, me qëllim të krijimit të mekanizmave për menaxhimin dhe trajtimin e rasteve specifike dhe urgjente, e që kanë nevojë të komunikohen në opinion me qëllim të parandalimit të keqinformimit dhe garantimit të sigurisë individuale apo shtetërore në raste të caktuara.

Kjo objektivë nuk përmban nënobjektiva por synohet të arrihet përmes pesë aktiviteteve konkrete të detajuara në Planin e Veprimit të kësaj strategjie, e të cilat aktivitete janë:

- Krijimi i ekipit të brendshëm nga Kryeprokurori i shtetit për komunikim me publikun në raste specifike;
- Krijimi i ekipit të përbashkët të prokurorisë dhe institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë për çështje të komunikimit me publikun dhe sipas nevojë me institucionet tjera;
- Trajtimi i rasteve urgjente në interes për publikun;

- Hartimi i komunikatave, sqarime, reagime, mbajtja e konferencave për këto raste dhe çështje tjera të rëndësishme, në koordinim të përfaqësuesve të institucioneve të zbatimit të ligjit.

## PLANI I VEPRIMIT

PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË SË KOMUNIKIMIT TË SISTEMIT PROKURRIAL TË KOSOVËS 2017/2020						
Aktivitetet	Indikatorët e matës	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kosto	Komentet/Sfidat
<b>1. NGRITJA E BESUESHMËRISË NË SISTEMIN PROKURRIAL TË KOSOVËS</b>						
<b>1.1 Rritja e komunikimit me publikun</b>						
1.1.1 Publikimi i buletinit të sistemit prokurorial,	Dymbëdhjetë buletine të botuara nga Këshilli Prokurorial dhe katër nga Prokuroria e Shtetit	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Partnerët mbështetës	Çdo muaj (për KPK-në) dhe çdo tre muaj (për PSH-në)	E buxhetuar	Mbledhja në kohë e materialit të nevojshëm për hartimin e tyre
1.1.2 Realizimi i fushatave vetdiesuese (mbajtja e	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjërata në fakultetet juridike dhe gazetarisë në</li> </ul>	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Partnerët mbështetës	Në vazhdimësi		Gjetja e fondeve për realizimin e

ligjëratave nëpër institucionet edukative arsimore, realizimi i spoteve televizive, broshurave dhe materiale tjera informuese),	<p>institucionet e arsimit lartë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Publikimi i spoteve televizive dhe</li> <li>• Publikimi i broshurave dhe materialeve tjera informuese.</li> </ul>				<p>Donatorët</p> <p>E buxhetuar</p>	spoteve televizive
1.1.3 Organizimi i konferencave të rregullta për media	Katër konferenca të mbajtura gjatë vitit	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Partnerët mbështetës	Çdo tre muaj brenda vitit	E buxhetuar	
1.1.4 Organizimi i takimeve të rregullta me qytetarë	Takimet e rregullta javore me qytetarë nga Prokurori Shtetit	Prokurori i Shtetit		Çdo javë	E buxhetuar	
1.1.5 Mbajtja e ligjëratave në institucionet e arsimit të mesëm	Ligjëratat të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe MASHT-in	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Policia e Kosovës, MASHT-i dhe MPB	Sipas nevojës dhe kërkesave	Nuk ka kosto	

1.1.6 Përmirësimi i funksionimit të faqes zyrtare	Përditësimi i rregullt i faqes zyrtare	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Partnerët mbështetës	Në vazhdimësi	E buxhetuar	Kostoja financiare, caktimi i zyrtarëve kompetentë për mirëmbajtjen e faqes zyrtare
1.1.7 Njoftimi i publikut lidhur me rastet e paraqitura nga qytetarët dhe nga mediat dhe rastet e iniciuara sipas detyrës zyrtare	Numri i përgjigjeve kthyese	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit		Në vazhdimësi	Nuk ka kosto	
<b>1.2. Përmirësimi i komunikimit të brendshëm</b>						
1.2.1 Organizimit të takimeve mujore apo edhe më të shpeshta, sipas nevojës të prokurorëve dhe	Numri i takimeve	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit		Në vazhdimësi	Nuk ka kosto	



zyrtarëve për komunikim						
1.2.2 Informimi i përditësuar i kryeprokurorëve për rastet e ndjeshme për publikun, nga prokurori i rastit	Numri i rasteve të raportuara nga prokurori i rastit	Prokurori i Shtetit		Në vazhdimësi	Nuk ka kosto	
1.2.3 Informimi i përditësuar i zyrtarëve për komunikim publik për rastet e ndjeshme për publikun, nga prokurori i rastit	Numri i rasteve të raportuara nga prokurori i rastit	Prokurori i Shtetit		Në vazhdimësi	Nuk ka kosto	
<b>1.3. Ngritja e koordinimit ndërinstitucional në fushën e komunikimit</b>						

1.3.1 Mbajtja e takimeve të rregullta dhe sipas nevojës polici, prokurori, gjykatë dhe institucioneve tjera	Takimet e rregullta brenda vitit me polici, gjykatë dhe institucionet tjera	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit		Në vazhdimësi	Nuk ka kosto	
1.3.2 Krijimi i ekipit të përbashkët për komunikim ndërinstytucional (të sigurisë dhe drejtësisë)	Ekipi i krijuar ndërinstytucional	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Institucionet tjera zbatuese të ligjit	2017/2018	Nuk ka kosto	
1.3.3 Lidhja e memorandumeve të bashkëpunimit në mes institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në fushën e komunikimit me publikun	Numri i memorandumeve të lidhura	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Institucionet tjera zbatuese të ligjit	Në vazhdimësi	Nuk ka kosto	
1.3.4 Mbajtja e konferencave të përbashkëta në mes të policisë dhe prokurorisë dhe	Konferencat e organizuara	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Policia e Kosovës dhe institucionet tjera zbatuese të ligjit	Në vazhdimësi	Nuk ka kosto	

sipas nevojës edhe me institucionet tjera zbatuese të ligjit						
1.3.5 Organizimi i trajnimeve të përbashkëta me institucione zbatuese të ligjit për çështjet e komunikimit	Numri i trajnimeve të mbajtura	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Institucionet tjera zbatuese të ligjit dhe partnerët mbështetës	Në vazhdimësi	Donator	Gjetja e fondeve dhe donatorëve
<b>2. NGRITJA E BASHKËPUNIMIT ME MEDIA</b>						
<b>2.1. Ngritja e resurseve adekuate njerëzore për komunikim me media</b>						
<b>Aktivitetet</b>	<b>Indikatorët e matës</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Institucionet përkrahëse</b>	<b>Afati kohor për realizim</b>	<b>Kosto</b>	<b>Komentet/Sfi dat</b>
2.1.1 Caktimi i prokurorëve përgjegjës për komunikim, në të gjitha prokuroritë	Numri i prokurorëve për komunikim nëpër prokurori	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit		2017/2018	Nuk ka kosto	Stimulimi i prokurorëve të caktuar, trajnimi,

2.1.2 Caktimi i prokurorit koordinator përgjegjës për komunikim	Koordinatori i caktuar	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit		2017/2018	Nuk ka kosto	Trajnimet
2.1.3 Caktimi i zyrtarëve përgjegjës për komunikim, në të gjitha prokuroritë dhe KPK-në	Numri i zyrtarëve për komunikim nëpër prokurori	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit		2017/2018	249,194.00	Kostoja dhe trajnimet
<b>2.2 Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve për media dhe prokurorëve</b>						
2.2.1 Krijimi i kushteve teknike për realizimin e detyrave të punës të zyrave për komunikim	Pajisjet teknike të siguruar	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Partnerët mbështetës	2018/2019	24,900.00	Kostoja dhe gjetja e donatorëve
2.2.2 Trajnimi i zyrtarëve dhe prokurorëve për komunikim me publikun	Numri i trajnimeve të mbajtura	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Partnerët mbështetës	Në vazhdimësi	Donatorët	Kostoja dhe gjetja e donatorëve
<b>2.3. Ngritja e kapaciteteve të gazetarëve të sektorit të drejtësisë në bashkëpunim me AGK-në</b>						

2.3.1 Unifikimi i praktikave për qasje në dokumente publike	Praktikat e unifikuara për t'u përgjigjur në kërkesat për qasje në dokumente publike në sistemin prokurorial	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit		2017/2018	Nuk ka kosto	
2.3.2 Organizimi i trajnimeve të përbashkëta me gazetarë	Numri i trajnimeve të organizuara	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	AGK dhe donatorët	Në vazhdimësi	Donatorët	Kostoja dhe gjetja e donatorëve
2.3.3 Krijimi i një grupi jo formal të zyrtarëve për komunikim, prokurorëve dhe gazetarëve të drejtësisë në bashkëpunim me AGK-në	Ekipi jo formal i themeluar	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	AGK dhe partnerët tjerë	2017/2018	Nuk ka kosto	Identifikimi i gazetarëve që mbulojnë fushën e drejtësisë
2.3.4 Mbajtja takimeve të kryeprokurorit të shtetit (dy herë në vit) me kryeredaktorët/	Dy takimet e mbajtura brenda vitit	Kryeprokurori i Shtetit	AGK, kryeredaktorët/redaktorët	Çdo gjashtë muaj	E buxhetuar	

redaktorët e mediave, në bashkëpunim me AGK-në						
<b>3. NGRITJA E BASHKËPUNIMIT ME SHOQËRINË CIVILE</b>						
<b>Aktivitetet</b>	<b>Indikatorët e matës</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Institucionet përkrahëse</b>	<b>Afati kohor për realizim</b>	<b>Kosto</b>	<b>Komentet/Sfidat</b>
3.1 Organizimi i hulumtimeve të përbashkëta, lidhur me gjendjen e sistemit të drejtësisë dhe luftimin e krimit	Hulumtimet e realizuara	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Shoqëria civile dhe institucionet tjera zbatuese të ligjit	Në vazhdimësi	Donatorët	Kostoja dhe gjetja e donatorëve
3.2 Organizimi i takimeve të përbashkëta për çështjet që i përkasin sistemit prokurorial	Tre takimet të mbajtura brenda vitit me përfaqësuesit e shoqërisë civile	Kryeprokurori i shtetit	Shoqëria civile dhe institucionet tjera zbatuese të ligjit	Çdo katër muaj	E buxhetuar	

3.3 Organizimi i trajnimeve të përbashkëta, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve	Numri i trajnimeve të organizuara	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Shoqëria civile dhe donatorët	Sipas nevojës	Donatorë	Kostoja dhe gjetja e donatorëve
3.4 Lidhja e memorandumeve të bashkëpunimit.	Numri i memorandumeve të lidhura	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Shoqëria civile	Në vazhdimësi	Nuk ka kosto	

#### 4. KOMUNIKIM MË EFIKAS DHE MË EFEKTIV PËR RASTET SPECIFIKE DHE URGJENTE

Aktivitetet	Indikatorët e matës	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kosto	Komentet/Sfi dat
4.1 Krijimi i ekipit të brendshëm nga Kryeprokurori i Shtetit për komunikim me publikun në raste specifike	Ekipi i themeluar për komunikim për raste specifike dhe emergjente	Kryeprokurori i Shtetit		2017/2018	Nuk ka kosto	

4.2 Krijimi i ekipit të përbashkët të prokurorisë dhe institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë për çështje të komunikimit me publikun dhe sipas nevojë me institucionet tjera	Ekipi i krijuar ndërinstitucionale	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Institucionet e drejtësisë, sigurisë dhe zbatuese të ligjit	2017/2018	Nuk ka kosto	
4.3 Trajtimi me urgjencë dhe njoftimi me kohë i publikut	Numri i konferencave dhe raportimet në media lidhur me rastet, të evidentuara në data bazën e krijuar për raportim	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Institucionet e përfaqësuara në ekipin e krijuar për komunikim për rastet specifike dhe urgjente	Sipas nevojës	Nuk ka kosto	
4.4 Hartimi i komunikatave, sqarime, reagime, mbajtja e konferencave për këto raste dhe çështje tjera të rëndësishme, në	Numri i komunikatave, sqarimeve dhe reagimeve të dërguara të mediat	Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit	Institucionet e përfaqësuara në ekipin e krijuar për komunikim për rastet specifike dhe urgjente	Sipas nevojës	E buxhetuar	



koordinim të përfaqësuesve të institucioneve të zbatimit të ligjit;						
--	--	--	--	--	--	--